



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.100 dt.03.07.1998

**PER
CAKTIMIN E HONORARIT PER ANETARET
E KESHILLIT TE KUJDESTARISE**

Këshilli i Bashkisë Qytetit Tiranë, në mbledhjen e dt.03.07.1998, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Kryetari i Këshillit të Kujdestarisë, “Për caktimin e një honorari për Anëtarët e Këshillit të Kujdestarisë”, në mbështetje të nenit.14, të ligjit Nr.7682, dt.09.03.1993 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Lokal”,

V E N D O S I

1. Të caktojë një honorar fiks për Anëtarët e Këshillit të Kujdestarisë me **2.000 lekë** në çdo 3 mujorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të Këshillit të Kujdestarisë nga Këshilli Bashkiak i Tiranës.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI